

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian DVORANI	Kryesues
Arjana FULLANI	Anëtar
Evelina QIRJAKO	Anëtar
Andi ÇELIKU	Anëtar
Medi BICI	Anëtar

Në dhomën e këshillimit të datës 07.02.2017, mori në shqyrtim çështjen administrative që i përket:

PADITËS : Artan Xhiku

I PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme Doganave

OBJEKTI: *Detyrimi i palës së paditur të paguajë pagën e paditësit për periudhën Peshor 2010 e deri në vijim.*

B. LIGJORE: *Nenet 129, 76 e vijues të K.Punës, 32 i K.Pr.C.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr.10007, dt 23.12.2010, ka vendosur: Detyrimin e të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të paguaje në favor të paditësit Artan Xhiku pagën, për periudhën Qershor 2010 deri në ekzekutim të vendimit.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.425, datë 01.03.2012 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 10007, dt.23.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me ndryshimin se detyrimi ndaj paditësit Artan Xhiku fillon për periudhën 02.06. 2010 deri në datën 09.03.2011 .

Kundër vendimit ka bërë ankim pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, e cila kërkoi prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 63 të Ligjit nr.49, datë 03.05.2012 të "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative".

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr. 425, datë 01.03.2012 të Gjykatat e Apelit Tiranë.

Tiranë, me 07.02.2017

Nr. 11243-01558-00-2012 Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-4 Vendimit (25)